

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Shenjtërimi / *el-Hurumeh* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"وَمَنْ يُعَظِّمْ حُرْمَاتِ اللَّهِ فَهُوَ خَيْرٌ لَهُ عِنْدَ رَبِّهِ"

"... respektimi i gjërave që ka shenjtëruar (*hurumaat*) Allahu është më e mira për të (robin) te Zotit i tij." (el-Haxh, 30)

Shenjtërimi (t'i mbash si të pacenueshme gjërat) është ikje nga mjerimi i kundërshtimit dhe i guximit prej kokëkrisuri.¹ Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është shenjtërimi i urdhrave dhe i ndalimeve²:

- Jo nga frika e ndëshkimit, meqë kjo do të ishte egoizëm
- Jo nga kërkimi i shpërblimit, meqë kjo do të ishte robëri ndaj kompensimit³

¹ Mosbindja mund të rezultojë nga guximi prej mendjelehti në shkeljen e të shenjtës a të pacenueshmes apo dhe vetëm nga dështimi për t'iu kushtuar asaj çfarë kërkon Allahu. Ky lloj guximi mund t'i referohet edhe humbjes së respektit dhe të madhërimit në gjendjen e intimitetit në nivelin e tretë.

² Ky është niveli i Islamit (rregullat e jashtme) i të besuarit, pasuar nga niveli i dytë apo *imani* dhe niveli i tretë apo *ihsani*. Urdhrave dhe ndalimeve mund t'i shtohen edhe të gjitha simbolet e Allahut dhe etiketat e fesë së Tij. Allahu thotë: "... respektimi i gjërave që ka shenjtëruar (*hurumaat*) Allahu është më e mira për të (robin) në sytë e Zotit të tij." (el-Haxh, 30)

³ Ky është koncepti që përsëritet shpesh: A duhet ta kërkojmë xhenetin e të ikim nga xhehenemi dhe vetëm kjo të jetë ajo çfarë synojmë me adhurimin e Allahut? Në *Medaarixh es-Saaliqin*, Imam ibn el-Kajjim, me dijen e tij të jashtëzakonshme e gjallërinë intelektuale, shqyrton këtë çështje duke ia shoqëruar argumentet e të gjitha anëve. Në vijim ke një përmbledhje të shkurtër të pikave të parashtruara: Ka dy anë të këtij argumenti dhe një mes. Njëra anë (kryesisht ajo e sufinjve) pohoi se Allahu meriton t'i bëhet adhurim, edhe sikur të mos kishte xhenet e xhehenem; sepse dashuruesit e vërtetë nuk kërkojnë gjë tjetër veç kënaqësisë së më të dashurit të tyre. Ana tjetër (ajo e racionalistëve, kryesisht dijetarë) pohoi se ky koncept është

- Madje as si demonstrim i kushtimit, meqë kjo do të ishte devocion i pretenduar⁴

Të gjitha këto janë forma të ndryshme të adhurimit të vetvetes.

Niveli i dytë është veprimi në përputhje me tekstin e dukshëm fetar dhe pranimi i standardeve të teuhidit, që janë vendosur në tekstet fetare dhe janë të mirënjohura për publikun:

- Duke mos kërkuar t'i analizosh pa nevojë⁵ (tekstet, faktet)
- Duke mos i riinterpretuar në mënyrë alegorike
- Duke mos shkuar përtej kuptimit të tyre të dukshëm duke bërë përngjasime⁶
- Duke mos pohuar se i kupton plotësisht ato apo të spekulosh rreth tyre

Niveli i tretë:

- Ta mbrosh qetësinë⁷ nga njollosja me guximin prej kokëkrisuri

heretik, meqë ka ajete e hadithe të shumta që na nxisin ta kërkojmë xhenetin dhe të ikim nga Zjarri, çka gjithashtu tregon se kjo qe rruga e më të mirëve nga njerëzimi – pejgamberëve dhe shoqëruesve të tyre. Imam Ibn el-Kajjim tha se mesatarja në këtë është të thuhet se njeriu duhet ta kërkojë xhenetin dhe të kërkojë të shpëtojë nga xhehenemi, megjithatë xheneti s'ka të bëjë vetëm me kopshtet e gjelbra dhe kënaqësitë trupore. Kurani dhe Suneti tregojnë qartë se kënaqësia më e madhe e xhenetit do të jetë afërsia ndaj Allahut, domethënë të parët e Tij dhe gëzimi në kënaqësinë e Tij. E kundërta mund të thuhet për xhehenemin. Imam Ibn el-Kajjim po ashtu argumentoi se zhdukja e plotë e vullnetit është e pamundshme për një krijesë të gjallë. Ajo çfarë kërkohet, në fakt, është pajtueshmëria e plotë me vullnetin e Allahut. Me pak fjalë, në kërkojmë xhenetin ku kënaqësia më e madhe është afërsia ndaj Allahut.

⁴ Kjo mund ta ketë kuptimin se personi nuk duhet të punojë për t'ia dëshmuar vetvetes kushtimin. Çfarëdo qëllimi tjetër përveç kënaqësisë së Tij, është një formë pretendimi. Dhe njeriu mund t'i shtirët edhe vetvetes për shpërblimin e respektit ndaj vetvetes apo ndjenjën e arritjes më parë sesa kënaqësisë së Allahut.

⁵ Të kërkosh njëmendësinë, kuptimet dhe format e plota të botës së padukshme, siç janë cilësitë e Zotit, engjëjt, jeta e përtejme.

⁶ Duke e konsideruar Allahun të ngjashëm me krijesat apo cilësitë e Tij të ngjashme me të tyret. Besimtari duhet t'i besojë cilësitë e Tij ashtu si i ka hije Atij, duke u bazuar në atë me çka Ai përshkroi Vetën apo në atë me çka i Dërguari i Tij e përshkroi, siç është gjithëfuqia, gjithëdija, të folurit, dashuria, hidhërimi, urtësia, dhe të gjitha cilësitë e tjera të përsosura të Tij; pa i mohuar, pa i shtrembëruar, dhe pa i konsideruar të ngjashme me të krijesave, dhe pa u munduar ta përshkruash njëmendësinë e tyre.

- Ta mbrosh gëzimin nga njollosja me siguri⁸
- Të mbrosh të parët tënd (të parët e Zotit me zemër) nga perdet e shkaqeve⁹

⁷ Atëherë kur të gjesh rehati dhe prehje te Zoti. Allahu thotë: “Allahu zbriti të thënët më të mirë: një Libër me pjesë të ngjashme që ritheksohen. Atyre që ia kanë frikën Zotit të tyre, u rrëqethen lëkurat prej tij, pastaj lëkurat dhe zemrat u qetësohen me kujtimin e Allahut.” (ez-Zumer, 23)

⁸ Siguria nga ndëshkimi i Allahut dhe nga ndryshimi i gjendjes në të cilën je.

⁹ Kemi komentuar më herët pasjen parasysh të shkaqeve ndërsa beson se Allahu është shkaktari kryesor dhe ai që kontrollon gjithçka. Ata të cilëve të parët e shkaqeve të dukshme ua pengon të parët e shkaktarit kryesor, do të privohen nga të parët (*shuhûd*) e Tij.